



PARAQITJE NË KOMISIONIN E EKONOMISË, FINANCAVE DHE TË PRIVATIZIMIT, 4 MAJ 2000.

Raporti Vjetor i Bankës së Shqipërisë, i cili tashmë është në duart tuaja, trajton me detaje zhvillimet në ekonominë shqiptare, në fushën monetare dhe të këmbimeve valutore, të mbikëqyrjes bankare, të sistemit të pagesave si dhe të vetë institucionit të bankës qendrore.

Pas krizës që kaloi vendi në gjysmën e parë të vitit 1997 dhe zbatimit me sukses të programit gjashtëmuor për stabilizimin e vendit, Shqipëria nënshkroi me FMN marrëveshjen ESAF2. Elementet qendrore të kësaj marrëveshjeje ishin përsëri sigurimi i një rritjeje të shpejtë të ekonomisë së vendit, ulja e inflacionit, disiplinimi i zhvillimeve fiskale për të reduktuar deficitin buxhetor, sidomos atë të financuar me burime të brendshme, zhvillimi i reformave institucionale për të konsoliduar çdo arritje në fushën makroekonomike si dhe përmirësimi i kuadrit legjislativ e rregullativ.

Në vitin 1998 zhvillimet ekonomike ishin brenda objektivave të përcaktuar. Në tërësi u realizuan objektivat sasiorë të vendosur. U siguria një disiplinim më i mirë i zhvillimeve fiskale, i shprehur së pari në respektimin e kufijve të vendosur për deficitin buxhetor. Mbi të gjitha, u arrit reduktimi i inflacionit nga 42 për qind në fund të vitit 1997 në 8.7 për qind, më pak edhe se sa objektivi i vendosur, në fund të vitit 1998. Në këtë reduktim, pa dyshim, ka një kontribut të rëndësishëm politika monetare, e shtrënguar dhe e matur, e zbatuar nga Banka e Shqipërisë. Mund të themi se viti 1998 shërben si pikënisje e rimëkëmbjes ekonomike të vendit.

Bazuar në situatën ekonomike dhe politike relativisht të qëndrueshme, të trashëguar nga viti 1998, objektivat për vitin 1999 u përcaktuan, gjithashtu, ambiciozë. Thelbi i programit ekonomik ishte përsëri sigurimi i një rritjeje të shpejtë ekonomike prej 8 për qind në vit, reduktimi i inflacionit në fund të vitit në nivelin 7 për qind, i financimit të deficitit buxhetor me burime të brendshme në 5.9 për qind të PBB-së.

Elemente të rëndësishme në programin ekonomik të vitit 1999 mbetën vazhdimi i reformave institucionale, forcimi i luftës kundër korrupsionit dhe kontrabandës, forcimi i kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës,

forcimi i sistemit gjyqësor, privatizimi si dhe forcimi i rendit dhe i qetësisë. Dy ishin arsyet kryesore që kërkonin theksim më të madh të këtyre elementeve:

- Në vitin 1998 pak u bë në këto drejtime.
- Nevoja për të siguruar konsolidimin e ekuilibrave makroekonomikë.

Në vitin e kaluar, ne të gjithë u bëmë dëshmitarë të zhvillimeve të paparashikuara të situatës në rajon, gjë e cila nuk mund të kalonte pa ndikime në ekonominë shqiptare. Lufta në Kosovë dhe shpërngulja e një populli të tërë krijoi një pasiguri të përgjithshme duke na bërë në fillim pesimistë mbi realizimin e programit ekonomik.

Kriza e Kosovës pati ndikime mjaft komplekse për Shqipërinë, megjithatë, mbështetja që u ofrua në mënyrë të menjëhershme dhe të gjithanshme si dhe angazhimi i qeverisë dhe i popullit, bëri që të mos cënohej arritja e objektivave sasiore. Aktualisht, thuhet me bindje se edhe gjatë vitit 1999 ekonomia shqiptare u zhvillua brenda kuadrit të programuar. Në këtë mënyrë, **viti që kaluam kontribuoi në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të vendit.**

Prodhimi i brendshëm bruto për vitin 1999 është rritur në masën 8 për qind. Struktura e ekonomisë shqiptare si dhe efekti i zëvendësimit midis rritjes së aktivitetit të degëve të ndryshme të ekonomisë minimizuan ndikimet negative të krizës në Kosovë. Shkurtimisht vërehet se **prodhimi bujqësor**, kontributi i të cilit në totalin e prodhimit është mbi 50 për qind, ruajti të njëjtën masë rritjeje si edhe një vit më parë, prej 5 për qind.

Bujqësia nuk u prek ndjeshëm nga zhvillimet në rajon, duke siguruar dhe bazën kryesore në rritjen e prodhimit të përgjithshëm. **Prodhimi industrial** u rrit në masën 6.4 për qind duke zënë rreth 12 për qind të totalit të prodhimit të përgjithshëm. Kjo rritje është kontribut i sektorit privat pasi, nga të dhënat zyrtare të disponueshme, prodhimi industrial në sektorin shtetëror është në një gjendje pak a shumë stacionare. Rritje relativisht të lartë kanë **shënuar dega e ndërtimit** dhe ajo e **transportit**, secila me 15 për qind. Ndërsa **dega e shërbimeve** regjistroi një nivel rritjeje prej 12 për qind. Kriza e Kosovës vlerësohet si një ndër faktorët kryesorë të rritjes së këtyre sektorëve.

Megjithë rritjen ekonomike, pak u bë për rritjen e punësimit në vend. Shifrat zyrtare tregojnë për një ulje të punësimit me rreth 4 mijë persona. Për qindja e papunësisë, në nivelin 18 për qind, përbën kuotën



më të lartë të regjistruar pas vitit 1995. Për më tepër, kjo shifër u rrit për të tretin vit rradhazi.

Nëse deri më sot nuk ka patur reagime të ashpra kjo vjen si pasojë e shkallës së lartë të emigracionit në Shqipëri dhe e punësimit në sektorin joformal. Nëse numri i emigrantëve shqiptarë, nga studime të ndryshme, vlerësohet të jetë 500-600 mijë vetë, është e pamundur të jepet një shifër për punësimin në tregun joformal. Mjafton të përmendim faktin që gjatë periudhës prill - qershor në Shqipëri u krijuan shumë vende pune të përkohshme, megjithatë shifrat zyrtare raportonin rritje të papunësisë.

Spektori i jashtëm u ndikua më tepër nga situata e rajonit. Periudha e konfliktit u shoqërua me hyrje të mëdha në mallra dhe në valutë. Kjo çoi në një rritje relativisht të madhe të rezervës valutore dhe në një tendencë të qartë në mbiçmimin e monedhës kombëtare. Gjatë vitit 1999 rezerva valutore u rrit me 97 milionë dollarë amerikanë ose 25 për qind, ku ndikim të konsiderueshëm kanë dhënë ndihmat që përfitoi Qeveria Shqiptare për përbalimin e kostos së krizës. Rezerva valutore e vendit ishte e mjaftueshme për të përbaluar 5.2 muaj importe mallrash dhe ndihmash.

Monedha e vendit u forcua rreth 3.9 për qind kundrejt dollarit amerikan dhe rreth 16.8 për qind kundrejt markës gjermane dhe monedhave të tjera përbërëse të euros. Hyrjet relativisht të larta në valutë të huaj, vlerësohen si faktori kryesor në forcimin e vlerës së monedhës kombëtare. Është llogaritur se në formën e të ardhurave nga turizmi, të transfertave korente dhe të atyre kapitale si dhe të shërbimeve qeveritare, kanë hyrë rreth 300 milionë dollarë amerikanë për periudhën prill - shtator të vitit 1999, shifër kjo pothuaj e barabartë me të ardhurat vjetore nga dërgesat e emigrantëve shqiptarë.

Politika fiskale u hartua në funksion të reduktimit të deficitit buxhetor e për rrjedhojë edhe të inflacionit. **Deficiti i mbuluar me burime të brendshme arriti në 4.9 për qind të PBB-së, 1 pikë përqindjeje poshtë objektivit** ose 1.7 pikë përqindjeje më pak se vitin e kaluar. Niveli i të ardhurave rezultoi rreth 90 miliardë lekë dhe 73 për qind e tyre u realizuan nga të ardhurat tatimore. Megjithatë, në vlerë absolute, të ardhurat nga tatimet dhe taksat paraqiten me mosrealizim gjë që nxjerr në dukje edhe një herë problemin e punës në dogana, evazionin fiskal, korrupsionin etj.. Me mosrealizim paraqiten edhe shpenzimet.

Totali i shpenzimeve në raport me PBB-në arriti në 28 për qind nga 31 për qind i parashikuari. Ende ka probleme në kryerjen e shpenzimeve buxhetore, gjë e cila ndikon negativisht dhe në zbatimin e politikës monetare. Së pari, shpenzimet nuk kryhen ritmikisht. Rreth 33 për qind e shpenzimeve gjithsej u kryen në tremujorin e fundit të vitit 1999 dhe gjysma e tyre vetëm në muajin dhjetor (51 për qind e shpenzimeve të tremujorit të fundit). Nga ana tjetër, çrregullimet në vjeljen e taksave u balancuan, më së shumti, nga shkurtime në shpenzimet e programuara, sidomos në shpenzimet kapitale. Shpenzimet kapitale u realizuan në masën 6.4 për qind të PPB-së nga 7.5 për qind që ishin planifikuar. Ashtu si në vitin 1998 edhe në vitin 1999 nuk kemi përmirësim në strukturën e shpenzimeve buxhetore. Kjo do të thotë më pak investime, më pak punësim dhe kufizim i mundësisë për rritje ekonomike në të ardhmen.

Politika monetare, në përputhje me objektivin kryesor të Bankës së Shqipërisë, arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, u hartua në funksion të reduktimit të mëtejshëm të inflacionit. Ndikimi i politikës monetare në këtë drejtim do të matej me respektimin e tre objektivave sasiore, kufirit të poshtëm për mjetet e huaja neto të Bankës së Shqipërisë, kufirit të sipërm për mjetet e brendshme neto të Bankës së Shqipërisë dhe kredisë neto të sistemit bankar për qeverinë. Të tre këta objektiva janë respektuar.

Politika monetare e zbatuar në Shqipëri gjatë këtyre viteve të fundit është përkufizuar si një politikë e shtrënguar dhe e matur. Duke pasur në vetvete dhe elementin "e matur", është shtuar mundësia që politika monetare të jetë fleksibël dhe t'i përshtatet zhvillimeve në vend. Politika monetare me kah zbutës e nisur në vitin 1998, vazhdoi gjatë gjithë vitit 1999. Kjo pasqyrohet në reduktimin e vazhdueshëm të normës së interesit për depozitat me afat në lekë. Norma minimale për depozitat me afat njëvjeçar ka pësuar një reduktim të ndjeshëm nga 27 për qind në fund të vitit 1997, në 16.5 dhe 9 për qind përkatësisht në fund të vitit 1998 dhe vitit 1999. Norma e miratuar në fund të vitit 1999 është niveli historik më i ulët i arritur nga viti 1992. Edhe në vitin 2000, Banka e Shqipërisë ka ulur normën e interesit dy herë për t'u ndalur në nivelin aktual prej 8 për qind. Këto vendime janë marrë duke u bazuar në zhvillimet në çmimet e konsumit, në forcimin e vlerës së lekut dhe në ecurinë e depozitave në sistemin bankar.

Ato kanë si synim uljen e kostos së financimit në ekonomi, kostos së shërbimit të borxhit të qeverisë dhe në afat më të gjatë nxitjen e rritjes



ekonomike. Megjithatë, vlen të theksohet që çdo vendim i marrë për uljen e normave të interesit është bazuar edhe në interesin për të ruajtur besimin e depozituesve në sistemin bankar duke ruajtur norma pozitive interesi në terma realë. Në fund të vitit 1999, niveli mesatar vjetor i interesit real për depozitat me afat njëvjeçar ishte rreth 7.6 për qind ndërsa në fund të muajit mars ky nivel është reduktuar në 5.3 për qind.

Ecuria e çmimeve të konsumit për vitin 1999 ishte e pazakontë për periudhën 1992-1999. Normat mujore të inflacionit rezultuan negative ose në nivele mjaft të ulëta pozitive duke siguruar që në fund të vitit 1999 të kishim një normë negative inflacioni prej 1 për qind, pra shumë poshtë objektivit. Faktorët që ndikuan në këtë sjellje janë të shumtë, duke nisur me forcimin e disiplinës fiskale, ndikimin e politikës monetare të zbatuar nga Banka e Shqipërisë, ecurinë e kursit të këmbimit etj..

Por, ndikimin kryesor e ka patur faktori *shock* domethënë, kriza e Kosovës, e cila, siç e shpjegova më lart, u shoqërua me një hyrje tepër të madhe valute fizike dhe mallrash në Shqipëri, duke plotësuar jo vetëm kërkesën e shtuar nga popullsia e shpërngulur, por edhe kërkesën e vetë popullsisë në Shqipëri.

Pra, faktori bazë në uljen e inflacionit ka qenë mbiçmimi i lekut me 16.8 për qind gjatë vitit 1999. Megjithatë, në uljen e inflacionit kanë ndikuar dhe një sërë faktorësh të tjerë si tkurrja kreditimit dhe e investimeve, niveli i ulët i inflacionit të importuar apo edhe vetë "ambjentimi" i publikut me një inflacion të ulët.

Ndërkohë, e njëjta tendencë po vijon edhe këtë vit. Norma vjetore e inflacionit, deri në fund të muajit mars, ka arritur në -2.1 për qind. Me këtë nivel, si dhe duke ditur sjelljen sezonale të çmimeve të konsumit, **konsiderohet i arritur dhe objektivi i inflacionit për vitin 2000.**

Megjithatë, Banka e Shqipërisë nuk do të jetë konstante në reduktimin e normave të interesit. Së pari, siç e theksova më sipër, ecuria e çmimeve të konsumit ka qenë e pazakontë, e diktuar nga faktori *shock*. Së dyti, është tepër e rëndësishme për Bankën e Shqipërisë të ruajë besimin e publikut në sistemin bankar, element i cili, për vetë zhvillimin e bankave në Shqipëri, ruhet edhe nëpërmjet interesave reale pozitive relativisht të larta.

Së fundi, por jo më pak i rëndësishëm është mosfunksionimi efektiv i mekanizmave në ekonomi. Me këtë duhet kuptuar që vendimet, që merr

Banka e Shqipërisë, nuk kanë në realitet efektin që pritet.

Arsyet e mosfunksionimit të këtij mekanizmi mund të jenë të shumta, por dua të veçoj përmasat e konsiderueshme të ekonomisë joformale, e cila redukton efektet e vendimeve dhe të politikave ekonomike. Po kështu, tregjet në Shqipëri janë ende në fazën fillestare të zhvillimit të tyre, për të mos thënë se nuk ekzistojnë. Në këtë mënyrë, ekonomisë i mungojnë kanalet nëpërmjet të cilave zbatohen me efektivitet vendimet që merren dhe politikat që hartohen.

Vendimet e Bankës së Shqipërisë për uljen e normës së interesit u shoqëruan me ulje të ndjeshme të *yield*-it të bonove të thesarit. Në harkun kohor të një viti, niveli i *yield*-it u ul përkatësisht me 5.1, 6.0 dhe 7.2 pikë përqindjeje për bonot e thesarit me maturim tre, gjashtë dhe dymbëdhjetëmuajor. Ndërsa, diferenca midis interesit të depozitave në lekë dhe bonove të thesarit me afat maturimi njëvjeçar ka mbetur pothuaj në të njëjtin nivel, rreth 6.5 pikë përqindjeje.

Për më tepër, duke patur parasysh shkallën e rrezikut politik dhe të rrezikut të vendit si edhe të monopolit që ekziston në tregun bankar, niveli aktual i *yield*-it të bonove të thesarit konsiderohet i përshtatshëm. Në tërësi, vërehet që subjektet, që veprojnë në tregun e letrave me vlerë të qeverisë, kanë reaguar në përputhje me vendimet e Bankës së Shqipërisë dhe pas një periudhe kohe të arsyeshme. Kjo ka ndodhur sepse ky treg funksionon dhe është ndër tregjet më aktive në Shqipëri.

Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për tregun e huadhënies. Nuk është e tepërt të pohojmë se, praktikisht, ky treg nuk ka reflektuar asgjë nga vendimet e Bankës së Shqipërisë.

Reduktimi i normave të interesit për depozitat nuk është shoqëruar me rritje të nivelit huadhënës. Për më tepër, është rritur kostoja mesatare e kreditimit nga 25 për qind në fund të vitit 1998 në 25.8 për qind në fund të vitit 1999. Ndërsa, diferenca midis interesit mesatar të huave dhe depozitave me afat maturimi një vit, është rritur gati dy herë (nga 8.5 pikë përqindjeje në 16.7 pikë përqindjeje).

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë në muajin nëntor 1999 mori vendimin për heqjen e kufirit të kreditimit për bankat e nivelit të dytë. Por, përsëri kreditimi mbeti në nivele mjaft të ulëta. Nga 8 miliardë lekë që ishte përcaktuar kufiri i kreditit për sektorin joqeveritar, në fund të vitit rezultoi se gjendja e kredive në sistemin bankar u rrit rreth 2.2 miliardë lekë ose



27.5 për qind e kufirit të kreditit. Mund të përmenden mjaft arsye për mosdhënien e kredive. Por, më të rëndësishme paraqiten:

- * rreziku i lartë i kreditit në Shqipëri gjë që i bën bankat private mjaft konservatore që të shtrihen në këtë aktivitet;
- * bizneset shqiptare nuk punojnë me bankat dhe si të tilla ato nuk janë kliente të sigurta për to;
- * bizneset shqiptare, gjithashtu, kanë një shkallë të ulët transparence në marrëdhëniet me bankat, duke u bërë pak të besueshme për to;
- * pengimi i bankave shtetërore për të dhënë hua si pasojë e nivelit të lartë të huave të këqija në këto banka dhe nisur nga nevoja për t'i mbrojtur ato nga pësimi i humbjeve të mëtejshme, që do të rrisnin koston e privatizimit;
- * mosfunksionimi efikas i sistemit gjyqësor dhe përmbarues;
- * pengesat në regjistrimin e pronave etj..

Pra, tregu i huadhënies në Shqipëri, praktikisht nuk funksionon. Janë vetëm disa banka private të cilat japin hua, kryesisht në valutë dhe më pak në lekë. Duhet kuptuar që banka qendrore nuk ka pushtet të detyrojë bankat e nivelit të dytë të rrisin nivelin e huadhënies. Këto banka, në bazë të ligjit në fuqi "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" kanë pavarësi në aktivitetin dhe në vendimmarrjet e tyre.

Ushtrimi i kontrollit nga Banka e Shqipërisë bëhet nëpërmjet vendimeve që ajo merr dhe instrumenteve që përdor. Duke qenë se këto vendime kanë rezultuar jo plotësisht të efektshme, banka qendrore po angazhohet gjerësisht në inicimin e një fushate për nxitjen e kreditimit në ekonomi.

Kjo fushatë, në rradhë të parë, synon të bëjë të njohur te klientët se si mund të merret kredi në bankë, çfarë kushtesh janë të detyruar të plotësojnë bizneset dhe individët për të qenë huamarrës në banka.

Nga ana tjetër, nëpërmjet fushatës synohet të identifikohen disa nga shkaqet e tjera, që mund të shkaktojnë kufizim në aktivitetin kreditues dhe në vijim të merren masat përkatëse për të reduktuar pengesat.

Nisur nga rëndësia që ka për ekonominë aktiviteti huadhënës, Banka e Shqipërisë do të angazhohet me burimet e saj njerëzore dhe do të mbështesë financiarisht këtë fushatë kreditimi për të kontribuar sadopak në përmirësimin e funksionimit të këtij tregu.

Megjithatë, është detyrë edhe e institucioneve të tjera që të kontribuojnë për krijimin e klimës së nevojshme për kreditim. Vendi kërkon rend e qetësi që edhe bizneset të jenë të interesuara për investime, edhe bankat të ndihen të sigurt në financimin e këtyre investimeve. Kërkohet forcim i zbatimit të ligjit dhe i sistemit gjyqësor. Efektshmëria në zbatimin e ligjit është e lidhur ngushtë me ecurinë e kreditimit pasi krijon mbështetjen dhe garancinë e nevojshme që paratë e dhëna do të kthehen në bankë. Forcimi i kontrollit të organeve tatimore, gjithashtu, ka vlerën e vet. Duke minimizuar mbajtjen e dy bilanceve nga ana e bizneseve, ato kthehen në kliente të besueshme për bankat.

Niveli i lartë i kredive me probleme në afat është një faktor frenues për kreditimin dhe rritjen e besimit të bankave te klientët. Sipas të dhënave më të fundit, kreditë me probleme arrijnë në 13.4 miliardë lekë ose 33 për qind e kredive gjithsej, në pjesën më të madhe në bankat shtetërore. Rreth 95 për qind e kredive me probleme janë në bankat shtetërore. I lartë mbetet dhe niveli i huave të klasifikuara të humbura në masën 7 miliardë lekë ose 76 për qind e huave të klasifikuara si me probleme. Nëse marrim parasysh dhe nivelin e interesave të klasifikuar si të humbur, rezulton se huatë e humbura gjithsej janë 10.7 miliardë lekë.

Një pjesë e konsiderueshme e këtyre huave janë trashëguar nga vitet e mëparshme, megjithatë, një shifër e tillë vlerësohet si me rrezik për sistemin bankar. Banka e Shqipërisë ka reaguar duke forcuar aftësinë e saj mbikëqyrëse për bankat e nivelit të dytë dhe duke forcuar zbatimin e kërkesave për krijimin e fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve nga huatë. Kjo situatë në portofolin e huave nuk do të thotë se gjithçka shkon keq në sistemin bankar. Përkundrazi, vërehen dhe mjaft zhvillime pozitive në të.

- Së pari, gjatë vitit 1999 filluan aktivitetin tre banka të reja private, Banka Fefad, Dega në Tiranë e Bankës së Parë të Investimeve dhe Banka Ndërtregtare. Ky është tregues i një besimi relativisht më të madh të investitorëve për të investuar në tregun bankar shqiptar. Vetëm Banka Fefad i shtoi portofolit të huave të sistemit bankar rreth 700 milionë lekë.
- Së dyti, është zgjeruar numri i degëve në rrethe. Gjatë vitit 1999 janë çelur dy degë bankash dhe tre agjenci.
- Së treti, megjithëse ende është i pranishëm deformimi i tregut bankar dhe monopoli i Bankës së Kursimeve, po forcohet tendenca që të rritet roli i bankave private duke premtuar për një funksionim më normal dhe më efikas të këtij tregu në të ardhmen.



- Së katërti, gjatë vitit 1999 sistemi bankar përmirësoi situatën financiare të tij. Nëse në fund të vitit 1998, rezultati financiar ishte negativ për 3.3 miliardë lekë, në fund të vitit 1999 sistemi bankar rezultoi me fitim për 1.3 miliardë lekë. Madje edhe rezultati neto nga interesat, që historikisht ka qenë negativ, në fund të vitit 1999 është pozitiv për 5.2 miliardë lekë.
- Së pesti, është forcuar pozicioni i kapitalit në banka për disa arsye. Më 31 mars 1998 Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori vendimin për rritjen e kapitalit minimal të paguar për bankat ekzistuese në 500 milionë lekë brenda muajit shtator 1999. Këtë vendim e respektuan pothuaj të gjitha bankat. Vetëm tri prej tyre nuk e respektuan dot afatin. Nisur nga shkaqet dhe kushtet e mosrespektimit, Banka e Shqipërisë miratoi shtyrjen e këtij afati deri në shkurt të vitit 2000 për një të tretën të kapitalit dhe deri në fund të vitit 2000 për dy bankat e tjera. Afati i ri i vendosur është respektuar. Kështu, kapitali i nënshkruar për krejt sistemin bankar është paguar në masën 90 për qind të tij. Niveli i kapitalit të bankave pritet të rritet si pasojë e zbatimit të vendimit tjetër të Bankës së Shqipërisë, që kapitali i paguar të arrijë masën 700 milionë lekë deri në fund të muajit mars të vitit 2001. Nga ana tjetër, është reduktuar ndjeshëm mungesa e kapitalit në grupin e bankave shtetërore dhe për pasojë edhe në sistemin bankar. Megjithatë, grupi i bankave shtetërore vazhdon të ketë pamjaftueshmëri kapitali si pasojë e humbjeve të trashëguara nga vitet e kaluara.

Por, viti 1999 nuk shënoi ndonjë përmirësim cilësor në lidhje me zhvillimin e sistemit të pagesave. Në përgjithësi, sistemi i pagesave ka të njëjtat probleme si edhe vite më parë: nivel i lartë i qarkullimit të *cash*-it, vonesa në transferimin e parave sidomos brenda vendit, diferenca të mëdha në teknologji si dhe në shtrirjen e rrjetit në sistemin bankar shqiptar etj..

Përveç rritjes së volumit të transaksioneve, si pasojë kryesisht e zgjerimit të sistemit bankar me banka dhe degë të reja, disa banka private futën në përdorim instrumente të reja pagesash si ATM, kartën DINERS CLUB dhe VISA etj., por që ende kanë përdorim të ulët.

Niveli i ulët i zhvillimit të sistemit të pagesave në Shqipëri është një faktor shtesë, që mban larg klientët nga bankat. Banka e Shqipërisë ka përgjegjësinë e vet në këtë drejtim dhe ajo është e angazhuar në kuadër të Komitetit Kombëtar të Pagesave si dhe nëpërmjet inicimit të disa projekteve në fushën e pagesave për të kontribuar në këtë drejtim.

Së fundi, dua të tërheq vëmendjen për një fakt. Në fjalën time disa herë përdora termat “duke iu referuar të dhënave zyrtare” apo “nisur nga të dhënat zyrtare gjykohet se”. Kjo nuk është një lojë fjalësh, por pasqyrim i një mangësie shumë të madhe në vendin tonë: mungesës së statistikave zyrtare të plota, që jepen në kohë dhe të sakta. Ende nuk është ndërtuar një sistem i llogarive kombëtare. **Me një fjali të vetme gjendja e statistikave në Shqipëri përkufizohet e mjerueshme.** Mungesa e të dhënave, me gjithë përpjekjet e INSTA-it, po krijon vështirësi për gjithë specialistët dhe vendimmarrësit.

Ajo është kthyer në një pengesë serioze për procesin e analizës, të kryerjes së parashikimeve dhe të marrjes së vendimeve të vlefshme për ekonominë shqiptare. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme nga autoritetet qeveritare. Duhet të forcohet baza ligjore për statistikën dhe përgjegjësitë për raportim të të dhënave.

Është e nevojshme të mbështeten financiarisht njësitë, që merren me grumbullimin dhe përpunimin e statistikave dhe në rradhë të parë të INSTA-it. Institucionet shtetërore dhe sidomos ministrinë duhet të rrisin shkallën e transparencës në lidhje me të dhënat statistikore dhe të bashkëpunojnë më mirë për shkëmbimin e informacionit.

Nga përvoja që ka Banka e Shqipërisë në marrëdhënie me këto institucione, vlerësoj që ka ende ngurtësi në shkëmbimin e informacionit, madje edhe moszbatim të kërkesave ligjore për këtë problem.

Së dyti, është i vlefshëm fillimi i një fushate edukuese për sektorin privat të ekonomisë dhe individët për të qenë më të hapur dhe jo të ngurtë në raportimin e të dhënave që u kërkohen.

Informacioni statistikor, që kërkohet të grumbullohet, vlen për qëllime studimi dhe për të marrë vendime sa më të vlefshme. Prej tyre përfitojnë të gjithë.

Rëndësi e veçantë, në vitin 1999, iu kushtua edhe vetë zhvillimit institucional të Bankës së Shqipërisë. Për këtë, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar, në muajin nëntor të vitit 1999, strategjinë e zhvillimit afatmesëm të bankës qendrore.

Ky dokument tashmë është bërë publik. Ai vendos në një rradhë të mirëzgjedhur etapat nëpër të cilat duhet ecur; problemet me të cilat do të ballafaqohet lëvizja drejt modelit të zgjedhur dhe, mbi të gjitha, burimet



tek të cilat do të mbështetet institucioni, që janë njerëzit me aftësitë dhe dëshirën e mirë për të punuar.

Dokumenti i strategjisë u përgatit me qëllim që:

- * Të vlerësohet niveli i arritur në zhvillimin e institucionit.
- * Të përcaktohen objektivat afatshkurtër dhe afatmesëm për zhvillimin institucional të Bankës së Shqipërisë.
- * Të përcaktohen afatet kohore për realizimin e objektivave.
- * Të përcaktohen prioritetet në zhvillimin e Bankës së Shqipërisë si institucion.

Objektivat e përgjithshëm strategjikë të Bankës së Shqipërisë kanë të bëjnë me gjithë aktivitetin e saj.

- * Së pari, dokumenti përcakton modelin institucional për t'u mbajtur në konsideratë nga Banka e Shqipërisë, që është **Banka Qendrore Europiane**.
- * Së dyti, Banka e Shqipërisë shpreh angazhimin **për rritjen e pavarësisë ligjore dhe reale** të saj, si banka qendrore e shtetit shqiptar, për t'i shërbyer sa më mirë detyrave të përcaktuara në ligj.
- * Së treti, Banka e Shqipërisë, gjithashtu, angazhohet **për të rritur përgjegjshmërinë e veprimeve dhe të vendimeve** të saj. Për këtë, ajo është angazhuar në rritjen e transparencës me publikun dhe "edukimin" e tij me probleme të natyrës ekonomike e financiare.

Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë, për herë të parë nga krijimi, raporton gjendjen e saj financiare të shoqëruar me opinionin e kontrollorit të jashtëm të pavarur. Ky është një hap i rëndësishëm në rritjen e transparencës së veprimitarisë së Bankës së Shqipërisë dhe në respektimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe të llogaridhënies. Madje, sipas opinionit të kontrollorëve, bilanci i Bankës së Shqipërisë prezanton, në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 1999 në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të përshtatura për politikën përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit të aplikueshme për bankat qendrore.

- * Së katërti, Banka e Shqipërisë kërkon të veprojë në një mjedis të qëndrueshëm ligjor, gjë që synohet të arrihet nëpërmjet **plotësimin dhe përmirësimin të paketës ligjore e rregullatore në fushën**

financiare.

- * **“Arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve”** është objektivi më i rëndësishëm strategjik i Bankës së Shqipërisë. Ky objektivi është materializuar në angazhimin për të mbajtur një normë vjetore inflacioni në nivelet 2-3 për qind. Politika monetare dhe ajo valutore do të harmonizohen dhe do të orientohen kah arritjes së këtij objektivi.
- * **Përmirësimi i statistikave** është një objektivi tjetër prioritar për Bankën e Shqipërisë. Në kushtet kur niveli i zhvillimit të statistikave në Shqipëri nuk është i kënaqshëm, Banka e Shqipërisë e pa të nevojshëm angazhimin në këtë proces dhe inicimin e dy projekteve për zhvillimin e statistikave me synim anëtarësimin në GDDS dhe SDDS.
- * **Zhvillimi dhe përmirësimi i sistemit të pagesave** me synim rritjen e qarkullimit të parave nëpërmjet sistemit bankar. Për këtë objektivi do të punohet në dy drejtime: në përmirësimin e sistemit të pagesave ndërbankare dhe të sistemit të pagesave me vlera të vogla.
- * Së fundi, është përcaktuar që realizimi i objektivave strategjike do të arrihet nëpërmjet **kualifikimit të kapitalit human të Bankës së Shqipërisë** dhe **zhvillimit të teknologjisë së informacionit**.

~~Aktiviteti ekonomik, i sistemit bankar dhe i Bankës së Shqipërisë është mjet i rëndësishëm për arritjen e qëllimit të përcaktuar në planin e afatgjatë. Megjithatë, besojmë se është dhënë një pasqyrë e qartë dhe korrekte e këtyre zhvillimeve, e cila do të vlerësohet realisht nga ju dhe publiku.~~